



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIVJAKË

SEKTORI JURIDIK DHE I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____

Divjakë më ____/____/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 07.01.2019]

Nga : Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjake

Adresa: Divjake, Sheshi "Santa Barbara", lagjia nr.2

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomik: "JOGI" shpk & "ERAL KONSTRUKSION" shpk

Adresa: Fier

Procedura e prokurimit: **"Tender i hapur"**

Me objekt: **"Rikonstruksion + shtese anesore ne shkollen 9 - vjecare fshati Shenepremte, Bashkia Divjake"**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikonstruksion + shtese anesore ne shkollen 9 - vjecare fshati Shenepremte, Bashkia Divjake"**.

Kohëzgjatja: 9 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit: **35 466 336 (tridhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, nga e cila: 70 % e vlerës nga FZHR dhe 30% nga Granti+Te ardhurat e Bashkisë Divjake.**

Burimi i financimit : **FZHR + Grant + Te ardhura**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **20.08.2018 Ora: 11:00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. REF-79658-07-18-2018

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara :

1. "ENI L" sh.p.k & "ZDRAVO" shpk J84003411K	22 896 371 leke pa tvsh
2. "SHKELQIMI" sh.p.k K68121808W	25 000 000 leke pa tvsh
3. "LLAZO" shpk & "ALUERA" shpk K24218401K	26 315 984 leke pa tvsh
4. "AVDULI" sh.p.k & "BAHAS" shpk J61827083D	26 537 991 leke pa tvsh
5. "SPEKTRI" sh.p.k & "SHENDELLI" shpk J62903555F	26 974 124 leke pa tvsh
6. "JOGI" shpk & "ERAL KONSTRUKSION" shpk J63229478K	28 185 600 leke pa tvsh
7. "MELA" sh.p.k & "ALB-SHPRESA" sh.p.k K62320011G	29 000 000 leke pa tvsh
8. "B-93" sh.pk & "KOLA INVEST" J62903508R	29 114 814 leke pa tvsh
9. "AURORA KONSTRUKSION" & "ARKONSTUDIO" K02017003I	29 743 270 leke pa tvsh
10. "XHIMO & KLEO" sh.p.k & "G.P.G" sh.p.k K59214101I	31 033 770 leke pa tvsh
11. "HASTOCI" sh.p.k K41523005C	33 366 525 leke pa tvsh
12. "ELDA - VL" shpk	0

Jane skualifikuar operatoret ekonomik si me poshte, per arsyet e meposhtme:

1. "ENI/L" & "ZDRAVO" per keto arsye:

- Dokumentacioni i paraqitur nga shoqeria "ENI/L" sh.p.k dhe "ZDRAVO" sh.p.k per plotesimin e kriterit "*pune e ngjashme*" nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit. Ne dokumentacionin e paraqitur nga te dyja keto shoqeri per permbushjen e ketij kriteri, ka shume zera te preventivit te cilat nuk perputhen me preventivin object prokurimi. Kjo vjen ne kundersizim me piken 2.3(f) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.
- Nuk eshte paraqitur dokumentacioni i kerkuar per punetori te specializuar ne ndertim per: - pllakashtrues (2) dhe suvatues (2), sic eshte kerkuar ne DST. Kjo vjen ne kundersizim me piken 2.3(h) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta te Kualifikimit

ne Dokumentat Standarte te Tenderit.

- Shoqeria “ENI/L” nuk ploteson kriterin *per numrin e punonjesve te siguruar*. Ne DST eshte kerkuar: Një punësim mesatar i të paktën 80 (tetedhjetë) personave duke përfshirë stafin e përhershëm, për periudhën Janar – dhjetor 2017; Janar – qershor 2018. Ne baze të përqindjes (70%) sipas kontratës së bashkëpunimit që shoqeria “ENI/L” ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi, numri mesatar i punonjesve të siguruar që duhet të kishte, është 56 punonjes, ndërkohë që numri mesatar i punonjesve të siguruar sipas llogaritjeve të bëra nga Komisioni i vlerësimit të ofertave për këtë shoqëri në baze të dokumentacionit të paraqitur, për periudhën e kerkuar është 28. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(j) “*kapaciteti teknik*”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.

2. “SHKELQIMI” sh.pk per keto arsye:

- Nuk është paraqitur dokumentacioni i kerkuar për punëtorin të specializuar në ndërtim për: - pllakashtrues (2), bojaxhi (2) dhe suvatues (2), sic është kerkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) “*kapaciteti teknik*”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Nuk është paraqitur asnjë nga dokumentat e kerkuar për të provuar disponimin e mjetit *Bobcat (cope 1)* sic është kerkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3 (i) “*kapaciteti teknik*”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.

3. “LLAZO” sh.p.k & “ALUERA” Sh.p.k per keto arsye:

- Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “LLAZO” sh.p.k për plotësimin e kriterit “*punë e ngjashme*” nuk është në përputhje me objektin e prokurimit. Në dokumentacionin e paraqitur nga kjo shoqëri për përmbushjen e këtij kriteri, ka shumë zera të preventivit të cilat nuk përputhen me preventivin objekt prokurimi. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(f) “*kapaciteti teknik*”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Në kontratën e bashkëpunimit, për bashkimin e perkohshëm të dy shoqërive “LLAZO” sh.p.k dhe “ALUERA” sh.p.k, është shënuar gabim fondi limit për këtë procedurë prokurimi.
- Për inxhinierin elektrik, pjesë e stafit teknik të “LLAZO” sh.p.k nuk është paraqitur licenca dhe librezë e punës. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) “*kapaciteti teknik*”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Nuk është paraqitur dokumentacioni i kerkuar për punëtorin të specializuar në ndërtim për: - saldator (1), sic është kerkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) “*kapaciteti teknik*”, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.

4. “AVDULI” sh.p.k & “BAHAS” sh.p.k per keto arsye:

- Nuk është paraqitur asnjë dokument që të provojë se pjesë e stafit teknik të njërës nga dy shoqëritë është *arkitekti* sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Për inxhinierin e mjedisit, nuk është paraqitur licenca dhe librezë e punës. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për punëtorë të specializuar në ndërtim për: - bojaxhi (1), dhe mekanik (2) sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Nuk është paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuar për të provuar disponimin e mjetit *Bobcat (cope 1)* sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3 (i) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Është paraqitur dokumentacion për skelëri 1000 m² dhe jo 1500 m² sic është kërkuar në DST.

5. "SPEKTRI" sh.p.k & "SHENDELLI" sh.p.k për këto arsye:

- Nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për punëtorë të specializuar në ndërtim për: - pllakashtrues (1), dhe mekanik (1) sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3(h) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Nuk janë paraqitur kontratat e punës për punëtorë të specializuar në ndërtim: pllakashtrues (2), karpentier (2), murator – suvaxhi (2), manovrator (3).
- Nuk është paraqitur dokumentacion për të provuar disponimin e mjetit *Bobcat (cope 1)* sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3 (i) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.
- Është paraqitur dokumentacion për skelëri 1300 m² dhe jo 1500 m² sic është kërkuar në DST.
- Sigurimi për mjetin kamion 15 ton, ka skaduar me datë 20.07.2018
- Nuk është paraqitur dokumentacion për *gjenerator (cope 2)* dhe *autopompe betoni (cope 1)* sic është kërkuar në DST. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 2.3 (i) "*kapaciteti teknik*", Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në Dokumentat Standarte të Tenderit.

6. "MELA" sh.p.k & "ALB-SHPRESA" sh.p.k për këto arsye:

- Shoqëritë kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi për bashkim të perkohshëm të shoqërive për dy objekte të ndryshme prokurimi: "*Rikonstruksion + shtesë anësore në shkollën 9 - vjeçare fshati Shenepremte, Bashkia Divjake*" dhe "*Rikonstruksion +*

shtese anesore ne shkollen 9 - vjecare "Hysi Malko," fshati Kryekuq, Bashkia Divjake" cka bie ne kundershtim me Dispozitat e ligjit te prokurimit si edhe dokumentat standarte te tenderit.

- Per shlyerjen e detyrimeve vendore, te dyja shoqerite kane paraqitur formular vetedeklarimi, cka bie ne kundershtim me piken 2.1.(a) *Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë*: Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit, ne te cilen kerkohet: a. *Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, per vitin 2018, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kete dokument).*

7. "AURORA KONSTRUKSION" & "ARKONSTUDIO per keto arsye:

- Nuk eshte paraqitur asnje nga dokumentat e kerkuar per te provuar disponimin e mjetit *Bobcat (cope 1)* sic eshte kerkuar ne DST. Kjo vjen ne kundershtim me piken 2.3 (i) *"kapaciteti teknik"*, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.
- Nuk eshte paraqitur asnje nga dokumentat e kerkuar per te provuar disponimin e *Motosaldatrice (cope 1)* sic eshte kerkuar ne DST. Kjo vjen ne kundershtim me piken 2.3 (i) *"kapaciteti teknik"*, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.
- Shoqeria "ARKONSTUDIO" nuk ka paraqitur listepagesat dhe vertetim per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen e kerkuar ne Dst. Kjo vjen ne kundershtim me piken 2.3(j) *"kapaciteti teknik"*, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit ne Dokumentat Standarte te Tenderit.

8. "ELDA – VL" shpk per arsye se:

- Nuk eshte paraqitur asnje nga dokumentat e kerkuar ne kete procedure prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **bashkimi i operatoreve ekonomik "JOGI" sh.p.k**, me nr nipti **J63229478K** dhe **"ERAL KONSTRUKSION" shpk** me nr Nipti **K82230002K** me oferte **28 185 600 leke pa tvsh (njezete e tete milion e njeqind e tetedhjetë e pese mije e gjashteqind)** leke pa tvsh, me adrese: Fier është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor Bashkia Divjake, me Adrese: Divjake , Sheshi "SANTA BARBARA"**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **06.12.2018**

Ankesa: ka ose jo, **jo, nuk ka pasur ankesa**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Fredi Kokoneshi

